

**AKT THEMELIMI**  
**I Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar**

**ALB PERFECTION DESIGN**

Sot, më datë 02.11.2023, personalisht:

Mirgen GJIRJA, atesia Petrit, shtetas Shqiptar, lindur ne Shkoder me 12.06.1993 dhe baunues ne Rr. Skenderbeu Nr.37, Fier, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Përpilon këtë akt themelimi të shoqërisë tregtare **ALB PERFECTION DESIGN sh.p.k.**, me termat e mëposhtme:

**NENI 1**

Të themelojë Shoqërinë Tregtare ALB PERFECTION DESIGN SH.P.K, në formën e një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar. Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria kundrejtuar të tretëve si dhe në të gjitha aktet e brendshme të saj, do të shënohet detyrimisht emri **ALB PERFECTION DESIGN SH.P.K.**, sipas përcaktimeve të bëra në këtë Akt Themelimi dhe në Statut.

**NENI 2 Qëllimi i krijimit të Shoqërisë.**

Qëllimi i krijimit të kësaj Shoqërie është zhvillimi i aktivitetit ekonomik në fusha të ndryshme. Veprimtaria e kësaj Shoqërie do të jetë thellësisht me karakter ekonomik dhe qëllim fitimprurës.

**NENI 3 Emri dhe vula e shoqërisë**

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin e subjektit **ALB PERFECTION DESIGN sh.p.k** dhe ajo do të ketë edhe vulën e saj.

**NENI 4 Objekti i veprimitarise**

Programacion, këshillime dhe aktivitete të tjera informatike, aktivitete të programimit informatik, faqet web, software dhe aplikacionet (përfshirë zbatimin dhe korigjin), adaptimin e software, dhe aplikacioneve ekzistuese për ti bërë funksional në mjedisin informatik të klientit, web (hosting), shërbime në vazhdimësi, përpunimi i të dhënave informatike etj. menaxhim i rrjeteve sociale, etj.

**NENI 5 Selia e Shoqërisë dhe Afati**

Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën: Rr. Sami FRASHERI, Nr. 4/146+2-N10, Tiranë.

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një periudhe kohore pa afat.



## **NENI 6 Kapitali i Shoqërisë**

Kapitali themeltar eshte 100.000 (njeqind mijë) Lek dhe zotërohet nga ortaku themelues.

Vlera totale e kapitalit te regjistruar: 100.000 leke

Vlera e paguar: 100.000 leke

Numri total i kuotave: 1

Kapitali themeltar eshte mbuluar tërësisht nga ortaku i vetem themelues.

## **NENI 7**

Ortaku themelues i Shoqërisë Tregtare ALB PERFECTION DESIGN sh.p.k zotëron kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:

- Mirgen GJIRJA, pjesemarrja me perqindje 100 %, i kuote, lloji i kontributit ne para 100.000 leke.

Kapitali themeltar eshte mbuluar tërësisht nga ortaku i vetem themelues.

## **NENI 8 Organet Drejtuese**

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Ortaku i Vetem – organi më i lartë vendimarrës;
2. Administratori – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

## **NENI 9 Administratori**

Shoqëria administrohet nga ana e Administratorit i cili zgjidhet për një mandat 5 (pese) vjeçar me të drejtë rizgjedhje. Administratori i parë te shoqërisë do të janë Z. Mirgen GJIRJA.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili i ushtron këto të drejta në përrputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjisacionin në fuqi.

## **NENI 10**

Oratku mund të vendose me vullnetin e tij, për pjesmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

## **NENI 11**

Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhđëmtojnë Shoqerinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre.



**NENI 12**

Mosmarrveshjet për themelimin e Shoqërisë zgjidhen me mirekuptim dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga Gjykata kompetente.

**NENI 13**

Akti i themelimit pasi u lexua nga Ortaku Themelues u gjet sipas vullnetit të tij dhe u nënshkrua pa vërejtje. Akti i Themelimi hartohet në gjuhën shqipe.

**ORTAKU I VETEM THEMELUES**

Mirgen GJIRJA

